Lezhë, më 27.12.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 27.12.2023, në orën 10:00, në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë", mbi mbledhjen e radhës të muajit Dhjetor 2023, të këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga zv/kryetari z. Agostin Marku, i autorizuar nga kryetari z. Ndue Luli, në mungesë të tij, i cili lexoi rendin e ditës.

- Agostin Marku: kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet me 21 vota PRO.

KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Nëntor 2023".

Është shqyrtuar nga Komisioni, ka kush ndonjë mendim ndryshe nga komisioni? S'ka.

Nga këshilltarët ka kush ndonjë mendim, ndonjë sugjerim? S'ka.

Kush është dakord?

Miratohet me 21 vota PRO.

KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.

Kalojmë te pika 2 - Projekt vendim "Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023".

Komisioni ka ndonjë vërejtje, ndonjë sugjerim?

Vetë përfaqësuesit e bashkisë?
Anëtarët e këshillit ke kush ndonjë vërejtje? S'ka kush është dakord?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ke. ABSTENIM nuk ke.
Kalojmë te pika 3 - Projekt vendim "Për miratimin e zgjedhjes së anëtarëve të kryesive dhe të kryetarëve të fshatrave në Bashkinë Lezhë".
Komisioni ke ndonjë sugjerim?
Vetë anëtarët e këshillit kanë ndonjë problem, ndonjë sugjerim?
Vetëm te Njësia Kolsh, kemi diçka, fshati Lalm, i cili realisht nuk ka banorë. Është i shkruar aty, por atje as nuk janë bërë zgjedhjet, as nuk mund të shtyhen zgjedhjet, as nuk mund t'i kalojë kompetencë kryetarit, prandaj duhet hequr nga projekt vendimi. Besoj anëtarët e këshillit që kanë monitoruar procesin atje, e dinë shumë mirë.
Atëherë, kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ke. ABSTENIM nuk ke.
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e bursave të nxënësve të regjistruar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024".
Komisioni përkatës ke ndonjë vërejtje apo sugjerim?
Vetë drejtoria e arsimit?

Këshilltarë të reçentë?
Kush është dakord?
Miratohet me 21 vota PRO
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 5 - Projekt vendim "Për trajtimin me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2023-2024?
Komisioni? S'ka ndonjë vërejtje
Drejtoria e Arsimit?
Po, fjala për ju.
- Jonida Gjoni (specialiste në D. Arsimit në bashki) -
- Mbas datës që është dorëzuar projekt vendimi për nxënësit e vitit të parë në arsimin profesional, është dhe një nxënëse që ka dorëzuar dosjen N.p.s ju e mendoni ta shtojmë, mepë dhe ka bursa, ne propozojmë ta shtojmë, që t'i jepet bursë edhe kësaj nxënëseje, pra ta merrni në konsideratë".
- Agostin Marku: Pra, ka një propozim shtesë, mepë-nëse bursa kemi në dispozicion, mepënëse nuk kemi nevojë të hyjmë në atë ndarjen e bursave, gjysmë-bursave etj, mepë ministria na ka sjellë bursa të mjaftueshme, nuk kemi nevojë të hyjmë në votim të fshehtë e gjëra të tjera, kriteret i plotëson gjithsecili nga ata nxënës, me shtesën që paraqet vetë Drejtoria e Arsimit, pra me këtë ndryshim,

a jeni dakord të miratojmë këtë projekt vendim?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 6 - Projekt vendim "Për rishqyrtimin dhe miratimin e bursave të nxënësve të viteve të ndërmjetme, të shkollës së mesme profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë, për vitin shkollor 2023 - 2024".
Komisioni ka ndonjë problem?
Vetë drejtoria e arsimit? S'ka
Anëtarët e këshillit?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 7 - Projekt vendim "Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Bashkisë së Veronës dhe Bashkisë Lezhë për projektin "Rigjenerimi i hapësirës publike përmes krijimit të qendrave të integruara të sporteve për pjesëmarrjen e të rinjve" (RE-GEN), në kuadër të programit URBACT IV".
Ka kush ndonjë pyetje?
Është një projekt që ne duhet ta falenderojmë bashkinë që ka konkurruar dhe e ka fituar.
Pjesa që jep bashkia është shumë e vogël, krahasuar me atë që merr. Është gjë pozitive dhe urojmë që sa më shumë projekte të tilla të na vijnë në këshillin bashkiak për t'i miratuar sepse vetëm i bëjmë mirë Lezhës, duke bërë të mundur që

të investojmë dhe me fonde të huaja.
Atëherë, kush është dakord?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 8 - Projekt vendim "Për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2025-2027 dhe të Buxhetit të vitit 2025".
Është një projekt vendim më tepër procedurial dhe teknik që ka të bëjë me afatet dhe procedurat që ndiqen për miratimin e buxhetit. Sipas këtyre që miratojmë ne sot, bashkia është e detyruar t'i sjellë për miratim në këshillin Bashkiak.
Pra, s'ka të bëjë me probleme të financimit, apo investimit, shërbimeve por thjesht një akt procedurial që i takon këshillit ta miratojë.
Ka ndonjë vërejtje?
Kush është dakord?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 9 - Projekt vendim "Për një shtesë dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".
E kemi shqyrtuar në komisionin e financës. Kemi rënë dakord. Është gjë pozitive. Janë fonde që i rishpërndan qeveria në fundin e vitit. Bashkia me kërkesat që ka parapitur, ka bërë të mundur që këtë fond ta thithë për Lezhën dhe në një farë mënyre mbyllet disa deficite në ato detyrimet e prapambetura që ka

shprehë shqetësimin rretheqimisht Kryetari i Bashkisë.
Keni ndonjë vërejtje ju si këshilltarë?
- Flutura Gjoni: Mendoj duhet sqaruar diçka.
Deri në 15 nëntor lejohet rialokimi i fondeve.
Për këtë duhet thënë që është një akt normativ
i posaçëm me të cilin është bërë një rishpërndarje
e fondeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
- Agostin Marku: Po, faleminderit.
Drejtoria e financës ka ndonjë gjë? Jo.
Kush është dakord që ta kalojmë?
Miratohet me 21 vota PRO.
KUNDRA nuk ka. ABSTENIM nuk ka.
Kalojmë te pika 10 - Projekt vendim "Për heqjen
nga kontabiliteti i debitorëve që nuk justifikohen
me dokumentacion financiar dhe ligjor".
- Pjetër Tushaj: Unë kam shqetësim për arsye që unë
kam 23 vjet në biznes dhe asnjëherë nuk më ka
ardhur kush në derë nga bashkia për të më thënë
për të paguar taksat. Çdo njeri është i detyruar, n.q.s
është i regjistruar te bashkia të plotësojë detyrimet.
Se për vonesat vjen gjoba. Tani si ka mundësi, unë
po i lë pa paguar një një vit dhe obligon vitin tjetër
të më falen tatimet. Ndërkohë që unë po shoh shumë
emra këtu që nuk ia vlen. N.q.s doni t'ua falni,
faljani. Unë nuk jam dakord. Nuk më ka falur
kush gjë tash 23 vjet.
- Agostin Marku: Faleminderit Pjetër.
Realisht komisioni e shqyrtoi, ka pothuajse të njëjtin
shqetësim me këshilltarin Pjetër Tushaj. Ne i thamë

edhe dy drejtorisë përkatëse që të bëjë të mundur që sot të japë argumenta për këtë. Janë disa procedura që realisht edhe vetë bashkia, dhe Drejtoria e Financës, edhe si rezultat i kontrolleve të zhvilluara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për çështje të stabilizimit të treguesve në kontabilitet. Megjithatë kjo nuk do të thotë që ne ta bëjmë rrugë këtë, por duhet të japin dhe ata argumenta sepse realisht nuk janë për çështje taksash dhe tarifash vendore nga ata që ngritët shqetësimin ju. Janë për disa probleme të tjera, që ata vetë do ne e thonë dhe janë për një periudhë kohe që vetë ligji i favorizon që të bëjmë një veprim të tillë. Nuk është gjë e mirë se në fund të fundit është një fond i konsiderueshëm i cili, nqs do ishte ngelë në kohë apo do interesoheshin institucionet përkatëse brenda bashkisë që ta bëjnë mbledhjen e këtyre detyrimeve, kthehet në produkt, në investime publike për qytetarët e Lezhës, megjithatë fjala për ju zoti nënkryetar.

- Ermal Pacaj: Po bëj një përmbledhje. Nuk bëhet fjalë për lekë taksash se taksat falen me ligj, por këtu bëhet fjalë për shuma të cilat janë të ngarkuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit përpara vitit 2010, për subjekte ashtu dhe për individë që kanë punuar në administratën e bashkisë. Bashkia e Lezhës nuk ka dokumentacion që t'i hedhë në gjyq ose t'i çojë në përmbarim. Ka kaluar periudha 10-vjeçare, koha e cila e parashikuar si detyrim.
- Flutura Gjoni: Nuk parashikohet asnjëherë si detyrim.

Periudha 10-vjeçare është për paraškrimin e kërkesë-
-padisë.

- Ermal Pacaj: Për kërkesë-padinë po them edhe unë.
Në vijë të përgjithshme, e kisha për të sqaruar
z. Tushaj, pra nuk bëhet fjalë për lekë taksash.
Nuk është se i fanë falë taksat dikujt, kjo është fanë
detyrime të ngarkuara nga KLSH për subjekte apo
për individë, të cilët nuk janë më në administratë,
të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi për të kthyer
paga të marra jo sipas ligjit apo për subjekte që
kanë bërë punime të cunguara gjatë ushtrimit të
kontrollit. Është thënë që x subjekt nuk e ka mbaruar
fiks punën, por pjesë dokumentare që bën të mundur
që bashkia të dërgojë në gjykatë ose përmbarim apo
që të marrë masa kundër tyre, mungon. Pra kanë
kaluar mbi 10 vjet që nuk është bërë asnjë hap për
t'u rimarrë ~~ato~~ lekë.

- Flutura Gjoni: Atëherë, unë i lexova gjithë këta
persona që ishin. Është ngritur dhe Komisioni Posaçë
relacionin. Komisioni ka bërë vetëm evidentim. Këto
janë para vitit 2010. I pamë edhe arsyet.
Unë kam disa pyetje për të shtruar.
Këtyre personave a u është bërë ndonjë njoftim, sepse
nuk ka këtu asnjë spostim, letër me postë zyrtare a
u është çuar?
Tjetër, i është çuar Drejtorisë së Tatimeve që filan
subjekt është aktiv? Keni dokumentacion për
këtë?
Pyetje tjetër, këta persona, disa që ishin këtu, nuk

po përmend emra, juve keni bashkëpunim edhe tani me ta. Me i thënë të plotën, ti do me bashkëpunu tani e mbrapa, por ke ca lekë për t'm'i dhënë. M'i jep ato lekë. Çdo lloj forme për të tërhequr lekët, për të mbledhë lekët e tua dhe asnjëherë nuk parashkruhen detyrimet, e thashë edhe përpara, parashkruhet vetëm >10 vjet është kërkesë për të bërë padinë. Ke dhe një mënyrë tjetër. Është rivendosje në afat. Keni bërë ju ndonjë përpjekje për rivendosje në afat të këtyre. Provojeni njëherë me kërkesa, këto që kanë vlera të vogla sepse e di që është një përqindje e vlerës së detyrimit.

Për këto desha përgjigje. Faleminderit.

- Agostin Marku: kush do dojë, të flasë, por mos ke ndonjë shpjegim profesional drejtoria.
- Ermal Pacaj: Në fakt është p/vendim i Drejtorisë Juridike.
- Agostin Marku: Dhe Drejtoria e Financës se ka të bëjë me heqjen nga kontabiliteti.
- Brikena Vuksani (Drejtoria e Financës në bashki) - Për vlerën e tyre nuk ka dokumentacion dhe janë të pambledhshme. Nuk ka arsye pse janë vendosur në kontabilitet.
- Flutura Gjoni: Edhe diçka tjetër, znj. Brikena, drejtoreshe

nuk penka dakord sepse është pa firmë shkresë që kam unë. Pse ne i bini kur s'jemi dakord drejtoret?

- Agostin Marku: Të nderuar këshilltarë, tani të bëjmë sqarimin dhe për procedurat që do ndjekim për votimin. Çështja shtrohet, një pjesë e mirë e këtyre detyrimeve janë dhe për individë, janë dhe për biznese dhe pjesa e konsiderueshme është për biznesit, por janë periudha të kohura që kanë të bëjnë me njësitë administrative. Reforma territoriale e filluar në vitin 2015 ka dhënë efektet e veta dhe në këtë çështje, që ka fshehtë një pjesë e mirë e dokumentave dhe detyrimet, duke filluar nga njësitë administrative, si rezultat i kësaj bashkia ka mungesë dokumentacioni. N.p.s bashkia do fillojë procedurat gjyqësore do harxhojë më shumë me to për çdo individ se sa taljë që i takon çdo individi. A është gjë e mirë kjo? Jo. Duhet t'i themi stop këtij modeli në të ardhmen, me konsolidimin e strukturave që kemi. Tani s'mund të themi që bashkia është e re, dhe nuk ka përvojën e duhur sepse po hyjmë në vitin e nëntë që është ndarja e re administrative, por një pjesë e mirë janë të trashëguara, me janë në një kohë shumë të gjatë, që kur ishin komunat. Megjithatë n.p.s ndonjë këshilltar ka ndonjë vërejtje, ndonjë sugjerim tjetër, urdhëro, fjala është për ju.
N.p.s s'ka, ne nuk mund të çojmë në përfundësi.

N.p.s ka një gjykim që ne s'duhet ta miratojmë, ne ta shtyjmë për plotësim dokumentacioni. Por që ta votojmë kundra një çështje që ka të bëjë me kontabilitetin e gjenë shumë gjëra të tjera që Flutura i njeh porsi unë. Drejtoresha dhe zv/kryetari, a mund të na thoni n.p.s këto vërejtje që kishin këshilltarët, a mundemi ne të lëmë një afat kohor për t'i plotësuar dhe ta shtyjmë, jo ta votojmë sot? Nuk shtrohet problemi se kemi bërë selektim dhe kemi marrë ca biznese për t'i favorizuar. Ky është një problem i akumuluar ndër vite dhe duan të pastrojmë llogaritë. Nuk është çështje këtu, hajde t'i bëjmë nder dikujt. Nuk është as këshilli për këtë punë. Nuk është as koncepti dhe mentaliteti i specialistëve në bashki për këtë, mendoj unë. Çështje shtrohet, n.p.s për ato vërejtje profesionale që i bëri dhe Flutura, a do kohë bashkia, apo mund ta gjejë spastrimin edhe sot. Se Flutura tha, a i keni bërë letra gjithsecilit që të bindemi që nuk kemi dokumentacion, nuk ka njohje, nuk i gjejmë etj. N.p.s ju e keni bërë një gjë të tillë, na thoni po dhe e mbyllim sot, e hedhim në votim. N.p.s jo, s'kemi pse ta djegim këtë projekt vendim i cili është shumë i nevojshëm të merret një mendim në këshill.

→ Erdhi këshilltarja Silvana Kole.

- Ermal Pacaj: Ne ishim shumë të parët që prej fillimit, me themi që nuk kemi dokumentacion, mund

të kenë penë të komunave ato lekë. Janë ezauruar hapat të cilat na çojnë në dritë ndjekjes së atyre lekëve. Duhet pastruar kontabiliteti. Kjo bëhet për efekt të balancimit të llogarive.

- Pjetër Noka: Unë mendoj që të shtyjmë

- Lirim Torba: Me thënë të drejtën, vërtet mund të na duket pak e çuditshme falja e këtyre detyrimeve, heqja nga kontabiliteti, por për mendimin tim është një detyrim përderisa kanë kaluar mbi 13 vite. Mund të rrinë në kontabilitet por megjithë, sot një vit do jemi në që të japim sugjerim për t'u hequr.

- Ermal Pacaj: Ne më përpara i jemi drejtuar këshillit të Bashkisë me disa subjekte të cilëve bashkia u kishte detyrim, por nuk kishte dokumente. Ishte e njëjta gjë, dhe ishin në vlerë shumë më shumë sesa sot. Ne po me vendim këshilli i kemi hequr dhe nuk i kemi njohur si detyrim i bashkisë kundrejt tyre.

- Marin Suta: E vetmja gjë që nuk më pëlqen është se disa nga këto janë me biznese të mëdhaja dhe na duhet t'i falim.

- Ermal Pacaj: Marin, nuk po falim asgjë.

- Agostin Marku: Edhe një sqarim, nuk po favorizohen as individë, as subjekte. Bashkia është në një hall. Nuk ka asnjë dokumentacion që t'i vërë para përgje-gjësisë këto subjekte për shumën që janë debitorë. Gjithsecili prej atyre bizneseve, sot mund të ketë një biznes dhe nuk shtrohet problemi për detyrime të

sotme ndaj bashkisë. Janë si debitorë për nuk ke dokumentacion justifikues.
Tani, ke 2 variante, të hedhim në votim ose për plotësim dokumentacioni, të shtyjmë.

- Gjetër Tushaj: Të folen tani në këtë periudhë ndërkohë që ne si bizneseve na bën kryetari ose nënkryetari që të paguajmë hapësirën publike Rota Madhe. Pse?, Bashkia është si një shtëpi e madhe që ngelet pa lekë o zotëri se ka investime etj. N.q.s të bëjmë një rrugë rurale këtë periudhë, diku ku kanë hall, të ulemi e të folim taksat. T'ia marrin zotëri.
- Tonin Jaku: Kam mbi 3-4 mesazhe që më dërgojnë firma ndërtuese dhe po më thonë që është abuzu me gjobat. dhe këto nuk janë thjesht taksa. dhe këto lekë, kur nuk janë marrë që viti 2010 e andej, si mund të merren më"? Sado të kundërshtojmë ne.
- Flutura Gjoni – Desha të sqaroj vetëm 2 probleme Unë e kam lexuar dhe relacionin dhe e vetmja kërkesë ishte se këtu në relacion nuk është thënë që janë ndjekë, veç është bërë evidentim. Asnjë lloj përpjekje për arkëtim. Nuk është se i kemi këto lekë cash dhe nuk po bëjmë rrugë e po ua falim këtyre.
- Ermal Pacaj: Nuk ke dokumentacion për.
- Flutura Gjoni: I qohet një shkresë – në regjistrat e Bashkisë Lezhë qi figuroni debitor. Unë punoj

në një institucion, që ndjek debitorët dhe jemi shumë e përgatitur në këtë pikë.

- Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve.

Me sa po kuptoj në debatin që po zhvillohet, ashtu siç e thanë dhe disa të tjerë përpara duhet të kuptojmë qartësisht dy gjëra. E para është ajo që thotë nënkryetari - nuk po flitet asgjë. Thjesht, këto lekë për sa kohë që nuk janë marrë dhe me të drejtë zej. Flutura thotë që mbase përpjekjet mund të mungojnë. - ka diçka - se po dokumentacion është përpjekje e dështuar.

→ Erdhi këshilltari Shtjefën Lleshi.

- Erin Ndreca: Nuk është gjë e mirë. Të gjithë biem dakord por po kuptohet qartësisht që nuk ka dokumentacion dhe pse mbase ajo që propozon Flutura është diçka shumë e drejtë, por është diçka e pamundur. Dhe të presim ne në moralin e atyre që kanë këto detyrime, nuk besoj se realizohet. A do ishte gjë e mirë? Përkundrazi. E mirëkuptoj shqetësimin e gjithsecilit prej jush dhe ndaj të njëjtin shqetësim me ju dhe nuk do doja të isha pjesë për të folë këta persona që i detyrohen qytetarëve të Lezhës, por është një shprehje që thotë: Më mirë një fund me dhimbje se një dhimbje pa fund. Duhet të kuptojmë që, përderisa këto lekë nuk janë mbledhur gjithë këto vite, është e pamundur që të mblidhen. Na vjen keq që jemi ne që do e kujtojmë si precedent, por mendoj që është shumë shumë e pakti

Mepë nuk ke dokumentacion, pse të mbajmë veten me ëndrra që mbase një ditë këto lekë do arkëtohen në arkën e Bashkisë Lezhë.
Mendimi im është që ta hedhim në votim dhe ta shkarkojmë nga kontabiliteti i Bashkisë. dhe pse në dukje duket vendim i padrejtë, unë në ligj dhe në realitet është një vendim më se i drejtë, që mos të ushqejmë veten me ëndrra se ky borxh një ditë do mblidhet nga Bashkia e Lezhës. Ju falenderoj.
- Agostin Marku: kush e do fjalën?
Atëherë kush është dakord që ky p/vendim të miratohet?
Rezultati i votimit është:
13 vota PRO.
3 vota KUNDER (këshilltarët Pjetër Tushaj, Alfons Troshaj, Arben Ndreu)
7 ABSTENIM (këshilltarët Rajmonda Prendaj, Klejvi Hoxhipi, Elsa Gazulli, Flutura Gjoni, Rrok Marku, Emanuel Përpjaku, Marin Suta).
Është një vendim që shumicën e thjeshtë e mori, por varet te karakteri, nëse hyn te ato vendime që do shumicën absolute. Do e verifikojmë.
Vazhdojmë me pikën tjetër - projekt vendim "Për emërtimin e shkollës 9-vjeçare Pllanë me emrin "Noke Smaçi"".
Kush është dakord?
Miratohet me 23 vota PRO.

KUNDRA nuk ka, ABSTENIM nuk ka.
Vazhdojmë me projekt vendimin tjetër "Për dhënie "Çertifikatë Mirënjohje", z. Marjan Ndoja".
Drejtor i një shkolle shumë të rëndësishme në Gjakovë që ka dhënë kontribut për binjakëzimin, sidomos për shkollat në Bregun e Matës.
Kush është dakord?
Rezultati i votimit është:
15 vota PRO
8 vota KUNDER nga këshilltarët: Artan Ndreu, Alfons Troshaj, Rrok Marku, Pjetër Tushaj, Pjetër Noka, Emanuel Përjaku, Tonin Jaku, Lirim Torba.
0 ABSTENIM
Miratohet.
Atëherë, duke ju falenderuar për kontributin e dhënë nga perudhori deri sot, pra nga konstituimi, kemi bërë një punë jashtëzakonisht të madhe si këshill me vendimmarrjet, sugjerimet, propozimet, pse jo dhe kritikave, ju uroj Gëzuar Vitin e Ri dhe për gjithë banorët e Lezhë ardhtë i mbarë viti 2024.
Faleminderit dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
- mbledhja u transmetua live në Facebook.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

Z/KRYETARI
Agostin Marku